



Lajmet e Fundit: Tiranë – Vihen në pranga 5 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale



21/06/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Silent 2”

Operacioni, i zhvilluar nga Sektori kundër Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në vijim të operacionit "Silent", që u zhvillua një javë më parë.

Sekuestrohen 2 snajpera, 4 armë zjarri kallashnikov, 2 armë zjarri automatike, 4 armë zjarri pistoletë me silenciator, 85 pako me fishekë të kalibrave të ndryshëm, një sasi e konsiderueshme krehra armësh, pjesë të ndryshme armësh, shënjestra optike për armët e precizionit (snajper), tre kallëpe tritoli, sasi lënde e dyshuar eksplozive, 2 palë portotarga elektrike për fshehjen e targave, një automjet, 3 aparate celulare, 2 laptopë, 5 paruke dhe një pasaportë e dyshuar e falsifikuar.

Arrestohet në flagrancë 27-vjeçari që i mbante në magazinën dhe në banesën, që i kishte marrë me qira.

Specialistët e Sektorit kundër Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, se në garazhin e një pallati, në rrugën "Peti", një shtetas mbante armë zjarri të llojeve të ndryshme, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Silent 2".

Në kuadër të këtij operacioni u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– E. P. (B) 27 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në garazhin e marrë me qira nga ky shtetas, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 2 snajpera (njëri prej tyre prodhim i viteve të fundit), 4 armë zjarri kallashnikov, 2 armë zjarri automatike, 4 armë zjarri pistoletë me silenciator, 85 pako me municion luftarak të kalibrave të ndryshëm, pjesë të ndryshme armësh, shënjestra optike për armët e precizionit (snajper), një sasi e konsiderueshme krehra armësh, tre kallëpe tritoli, sasi lënde e dyshuar eksplozive, 2 palë portortaga elektrike për fshehjen e targave dhe 5 paruke.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës së marrë me qira nga shtetasi E. P. (B.), u gjetën dhe u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale një automjet në përdorim nga ky shtetas, 3 aparate celulare, 2 laptopë dhe një pasaportë e dyshuar e falsifikuar.

Po punohet për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linge

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Ajencia e Mbrojtjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

